

Data: 09.07.2026

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “RINOVIMI I PLOTË TEKNOLOGJIK I SISTEMIT TË LARGIMIT TË UJËRAVE NGA GALERITË E THELLËSISË SË CENTRALIT, PËRFSHIRË IMPIANTET ELEKTRIKE TË FUQISË DHE KONTROLLIT TË ELEKTROPOMPAVE TË THELLËSISË DHE DRENAZHIT”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË NDRYSHME - 39300000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 84,820,450 (Tetëdhjetë e katër milion e tetëqind e njëzetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 904,462 (Nëntëqind e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 09.07.2026 është 93.78 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet: *“Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43 pika a e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që Operatori Ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me termat e referencës dhe specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë

disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të fondit limit. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit:

Ligjin Nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar).

Vendim nr. 211, datë 9.4.2025 Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave. “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Udhëzim nr. 24, datë 6.11.2025 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës,

ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Kjo përqindje është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citohet se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e furnizimeve të ngjashme me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë ka si qëllim sigurimin e faktit që operatori ekonomik ka përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të realizuar kontrata të ngjashme me atë që po kërkohet. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor synon të sigurojë se operatori ekonomik ka kapacitetin për të përmbushur kërkesat dhe për të ofruar produkte që janë të ngjashme në natyrë dhe në vlerë me ato që janë të parashikuara në kontratë. Operatorët ekonomikë që kanë përvojë të mëparshme në fushat e ngjashme janë më të besueshëm në ofrimin e produkteve që kërkohen.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ SSH EN ISO 9001 - “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- ✚ SSH/EN/ISO 45001 - “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenit 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Autoriteti ka vendosur si kriter kualifikues kriteret e mësipërm pasi këto kriteret i japin sigurinë autoritetit kontraktor që operatori ekonomik fitues do përmbushë kërkesat për realizimin me sukses të kontratës së shpallur. Kërkesa në lidhje me këto certifikata mundëson një menaxhim të mirë të cilësisë dhe sigurisë së punonjësve. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vërtetuar se mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë. Është kërkuar që operatorët ekonomik duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Konkretisht:

✚ **SSH EN ISO 9001- “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e risqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

SSH EN ISO 9001 në këtë kontekst siguron që të gjitha pajisjet dhe mallrat që do të furnizohen objekt i kontratës janë të kontrolluara nga OE i cili është i certifikuar për verifikimin e cilësisë së duhur.

✚ **SSH/EN/ISO 45001 - “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”**- Është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e risqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Objekt i kësaj procedure ndër të tjera do të jetë vendosja/instalimi i elektropompave të thellësisë, vendosja/instalimi i elementëve të sigurisë (valvul mos-kthimi dhe saraçineskë) si dhe instalimi i paneleve të kontrollit dhe fuqisë. Këto procese do të realizohen në kushte që cilësohen me shkallë të lartë rreziku pasi janë në hapësira të ngushta, në prani të tensionit, etj. Nisur nga natyra e këtyre proceseve është e rëndësishme që operatori ekonomik të disponojë certifikimin SSH/EN/ISO 45001, i cili është vendosur për të garantuar se operatori zbaton një sistem të strukturuar të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me praktikat kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky standart siguron identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rreziqeve në vendin e punës, duke ulur mundësinë e aksidenteve dhe incidenteve gjatë ekzekutimit të kontratës. Për më tepër, ai garanton që operatori ka procedura të dokumentuara për menaxhimin e rreziqeve, trajnimin e personelit, monitorimin

e kushteve të punës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, minimalisht për periudhën Prill 2026 - Qershor 2026, jo më pak se 2 (dy) inxhinierë nga të cilët të paktën:

- ✚ 1 (një) inxhinier mekanik;
- ✚ 1 (një) inxhinier elektrik;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomat e inxhinierëve;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Prill 2026 - Qershor 2026.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar. Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike dhe termat e referencës për objektin e kërkuar. Autoriteti Kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Kërkesa se operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht për periudhën Prill 2026 - Qershor 2026, jo më pak se 2 (dy) inxhinierë, nga të cilët të paktën të paktën, 1 (një) inxhinier mekanik dhe 1 (një) inxhinier elektrik, është kërkuar pasi operatori ekonomik i cili do të realizojë këtë furnizim duhet të disponojë një minimum kapacitetesh burimesh njerëzore, në mënyrë që të tregohet se operatori ekonomik, zotëron mundësinë për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

✚ 1 (një) inxhinier mekanik - kërkohet pasi lidhet ngushtësisht me termat e referencës dhe specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Konkretisht:

Objekti i kësaj procedure prokurimi përfshin furnizimin dhe vendosjen/instalimin e mallrave të fushës mekanike, konkretisht pompat e thellësisë, valvulat e mos-kthimit dhe saraçineskat, të cilët përbëjnë komponentë teknikë të specializuar dhe duhet të prodhohen në përputhje të plotë me kërkesat e specifikimeve teknike.

Duke marrë parasysh natyrën teknike të këtyre komponentëve, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë në stafin e tij minimalisht 1 (një) Inxhinier Mekanik me diplomë të arsimit të lartë, i cili garanton njohuritë e nevojshme profesionale për interpretimin e specifikimeve teknike, dimensioneve, tolerancave dhe parametrave mekanikë të nevojshëm të mallrave/pajisjeve që do të furnizohen dhe vendosen/instalohen.

Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik do të realizojë porositjen dhe instalimin e mallrave/pajisjeve objekt kontrate në përputhje të plotë me kërkesat e specifikimeve teknike, duke minimizuar rrezikun e mospërputhjes teknike, defekteve në montim apo mosfunksionimit të pajisjeve. Prania e një inxhinieri mekanik në staf garanton vlerësimin e saktë teknik të produktit, kontrollin e përputhshmërisë dhe mbështetjen gjatë fazës së prodhimit, furnizimit dhe instalimit, duke rritur sigurinë për realizimin me cilësi të kontratës.

✚ 1 (një) inxhinier elektrik- kërkohet pasi lidhet ngushtësisht me termat e referencës dhe Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. Autoriteti Kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Konkretisht:

Objekti i kësaj procedure prokurimi përfshin furnizimin dhe vendosjen/instalimin e mallrave të fushës elektrike konkretisht, elektromotorët e pompave të thellësisë dhe panelet e kontrollit dhe të fuqisë së elektropompave të thellësisë dhe drenazheve të cilët përbëjnë komponentë teknikë të specializuar dhe duhet të prodhohen/porositen në përputhje të plotë me kërkesat e specifikimeve teknike.

Duke marrë parasysh natyrën teknike të këtyre komponentëve, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë në stafin e tij minimalisht 1 (një) Inxhinier Elektrik me diplomë të arsimit të lartë, i cili garanton njohuritë e nevojshme profesionale për interpretimin e specifikimeve teknike, karakteristikave dhe parametrave elektrikë të nevojshëm të mallrave/pajisjeve që do të furnizohen dhe vendosen/instalohen.

Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik, do të realizojë porositjen dhe instalimin e mallrave/pajisjeve objekt kontrate në përputhje të plotë me kërkesat e specifikimeve teknike, duke minimizuar rrezikun e mospërputhjes teknike, defekteve në montim apo mosfunksionimit të pajisjeve. Prania e një inxhinieri elektrik në staf garanton vlerësimin e saktë teknik të produktit, kontrollin e përputhshmërisë dhe mbështetjen gjatë fazës së prodhimit, furnizimit dhe instalimit, duke rritur sigurinë për realizimin me cilësi të kontratës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, minimalisht për periudhën Prill 2026 - Qershor 2026, punonjësit teknik si më poshtë:

- ✚ 1 (një) specialist saldator;
- ✚ 1 (një) specialist elektrikist;
- ✚ 1 (një) specialist për zhytje/polumbar;

✚ Operatori ekonomik ofertues specialistin për zhytje/polumbar, mund ta ketë këtë pjesë të stafit ose me kontratë/marrëveshje bashkëpunimi, me subjekte/individ polumbarë të certifikuar për zhytje nën-ujë të cilët të garantojnë ofrimin e këtij shërbimi.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

Për specialistët e punësuar në stafin e tij, minimalisht për periudhën Prill 2026 - Qershor 2026, duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën, minimalisht për periudhën Prill 2026 - Qershor 2026;
- ✚ Çertifikatat përkatëse të lëshuara nga institucionet e autorizuar me ligj.

✚ Për specialistin për zhytje/polumbar, nëse nuk rezulton në listëpagesat e shoqërisë, duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- ✚ Kontratë/marrëveshje bashkëpunimi;
- ✚ Çertifikatat përkatëse të lëshuara nga institucionet e autorizuar me ligj.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me specifikimet teknike dhe termat e referencës për objektin e kërkuar. Autoriteti Kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

✚ Kërkesa se operatori ekonomik duhet të ketë në stafin për periudhën Prill 2026 - Qershor 2026, minimalisht punonjësit teknik, është kërkuar pasi operatori ekonomik i cili do të realizojë këtë furnizim duhet të disponojë një minimum kapacitetesh burimesh njerëzore, në mënyrë që të tregohet se operatori ekonomik, zotëron mundësinë për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

✚ 1 (një) specialist saldator - Është kërkuar si kriter pasi lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. Autoriteti Kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Konkretisht:

Objekti i kësaj procedure prokurimi përfshin furnizimin dhe vendosjen/instalimin e mallrave të fushës mekanike, konkretisht pompat e thellësisë, valvulat e mos-kthimit dhe saraçineskat. Procesi i vendosjes/instalimit të elektropompave, valvulave të mos-kthimit dhe saraçineskave kërkon realizimin e proceseve të saldimit.

Duke marrë parasysh natyrën teknike të këtyre komponentëve, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë në stafin e tij minimalisht 1 (një) saldator me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri ose ndërkombëtar, i cili garanton njohuritë e nevojshme profesionale për realizimin e proceseve të nevojshme të saldimit gjatë instalimit të elektropompave dhe aksesoret e tyre.

Kjo kërkesë synon të sigurojë që OE do të realizoj kontratën në përputhje të plotë me kërkesat e specifikimeve teknike, duke minimizuar rrezikun e mos realizimit të vendosjes/instalimit në kohë dhe me cilësi.

✚ 1 (një) specialist elektrikist - Është kërkuar si kriter pasi lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. Autoriteti Kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Konkretisht:

Objekti i kësaj procedure prokurimi përfshin furnizimin dhe vendosjen/instalimin e mallrave/pajisjeve të fushës elektrike, konkretisht elektromotorët e pompave të thellësisë dhe panelet e kontrollit dhe të fuqisë së elektropompave të thellësisë dhe drenazheve.

Duke marrë parasysh natyrën teknike të këtyre komponentëve, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë në stafin e tij minimalisht 1 (një) specialist elektrik me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri ose ndërkombëtar, i cili garanton njohuritë e nevojshme profesionale për realizimin e proceseve të nevojshme gjatë instalimit të elektropompave dhe paneleve të kontrollit dhe fuqisë.

Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik do të realizoj kontratën në përputhje të plotë me kërkesat e specifikimeve teknike, duke minimizuar rrezikun e mos realizimit të vendosjes/instalimit në kohë dhe me cilësi.

✚ 1 (një) specialist për zhytje/polumbar - Ky kriter lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar dhe natyrën e operacioneve të nevojshme gjatë instalimit të elektropompave. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij një polumbarë për zhytje nën ujë të certifikuar nga organizëm i akredituar në Shqipëri ose ndërkombëtar, ose duhet të ketë kontratë/marrëveshje bashkëpunimi me subjekte/individ polumbarë të certifikuar për zhytje nën-ujë të cilët të garantojnë ofrimin e këtij shërbimi.

AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Konkretisht:

Objekti i kësaj procedure prokurimi përfshin furnizimin dhe vendosjen/instalimin e mallrave/pajisjeve të fushës mekanike, konkretisht elektropompave e thellësisë, valvulat e mos-kthimit dhe saraçineskat. Sistemi i largimit të ujërave nga elektropompat e thellësisë për në biefin e poshtëm të HEC Fierzë është i përbërë nga elektropompat, valvulat e mos-kthimit, saraçineskat dhe tubacionet përkatës për secilën elektropompë. Valvulat e mos-kthimit dhe saraçineskat janë të vendosura brenda godinës së HEC Fierzë në kuotën 167 m.m.n.d ndërkohë tubat e largimit të ujërave përfundojnë në biefin e poshtëm. Kuota e ujit në biefin e poshtëm arrin deri në 175.5 m.m.n.d. Në momentin që do të demontohen valvulat e mos-kthimit dhe saraçineskat ekzistuese deri në momentin që do të montohet saraçineskat e reja, për shkak të diferencës së kuotave do të futet uji nga biefi i poshtëm në sallën e makinerive të HEC Fierzë e cila mund të shkaktojë dëmtime të pajisjeve/sisteme të HEC-it. Për të eliminuar këtë rrezik, është e nevojshme të realizohet izolimi i përkohshëm i daljes së tubacioneve të shkarkimit të ujërave të cilët përfundojnë në biefin e poshtëm. Për të realizuar këtë proces është e nevojshme të realizohen zhytje nën ujë me polumbarë të cilët do të aksesojnë daljet e tubacioneve të shkarkimit dhe do të realizojnë izolimin e përkohshëm të tyre përpara se të filloj procesi i demontimit të elementëve ekzistues.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për mallrat objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Autorizimi i prodhuesit ose i distributorit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave dhe ka suportin teknik të tij për projektimin, prodhimin dhe testimet në vend të mallrave objekt kontrate. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për kredibilitetin në përmbushjen me sukses të kontratës.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallit objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike.

Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/katalogëve teknikë për mallrat objekt prokurimi justifikohet nga nevoja për verifikimin e përputhshmërisë së plotë të produkteve të ofruara

me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Duke qenë se mallrat kanë karakter teknik dhe duhet të integrohen me sistemin ekzistues, katalogu shërben si mjet zyrtar për identifikimin e karakteristikave teknike, parametrave dhe performancës së tyre, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë në mënyrë objektive nëse produkti i propozuar përmbush kërkesat e vendosura.

Kërkesa që në katalog të shënohen qartë dhe në mënyrë të dallueshme artikujt e ofruar dhe specifikimet përkatëse synon të shmangë paqartësitë dhe interpretimet e ndryshme, duke siguruar transparencë dhe krahasueshmëri të ofertave. Kjo i mundëson Autoritetit Kontraktor të bëjë një vlerësim teknik të saktë dhe të verifikueshëm, duke garantuar që malli i furnizuar është në përputhje të plotë me kërkesat teknike dhe standardet e kërkuara në procedurën e prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë propozimi teknik për elektropompat e reja të thellësisë.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me propozim teknik është kërkuar pasi:

Për shkak se niveli i filtrimeve në galerinë e thellësisë është i lartë dhe imponon një regjim pune me ngarkesë të lartë të elektropompave ekzistuese, në specifikimet teknike është përcaktuar që kapaciteti i elektropompave të reja të thellësisë duhet të jetë më i lartë se elektropompat ekzistuese. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të paraqesë një propozim teknik mbi kapacitetin e elektropompave që do të ofertojë ku të evidentohen qartë llogaritjet hidraulike të sistemit me elektropompat e reja dhe të përcaktojë fuqinë dhe prurjen e elektropompave të reja që do të furnizojë duke respektuar kushtet (hapësirat, dimensionet) e vendit të instalimit .

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

Grupi i punës ka ndërmarrë procesin për hartimin e specifikimeve teknike për rinovimin e plotë teknologjik të sistemit të largimit të ujërave nga galeritë e thellësisë së centralit, përfshirë impiantet elektrike të fuqisë dhe kontrollit të elektropompave të thellësisë dhe drenazhit.

Ky proces bazohet në gjendjen aktuale dhe nevojës për garantimin e sigurisë së godinës së HEC Fierza. Duke qënë se elektropompat e thellësisë dhe drenazheve janë elementët kryesor që garantojnë sigurinë e godinës nëpërmjet largimit të ujrave nga galeritë e thellësisë dhe drenazheve, parimi kryesor i hartimit të specifikimeve është garantimi i përputhshmërisë së plotë teknike dhe operacionale me kushtet e objektit.

Për këtë arsye specifikimet teknike si dimensionet, ngarkesat, prurjet, etj janë nxjerrë duke marrë për referencë të drejtpërdrejtë paisjet/sistemet ekzistuese dhe duke synuar përmirësimin e tyre referuar standarteve dhe praktikave aktuale. Për identifikimin e saktë të objektit të investimit është realizuar paraqitja e të dhënave ilustruese përmes fotografive dhe skemave përkatëse, duke garantuar kështu njohjen e plotë me çdo specifikë të nevojshme përpara ofertimit.

Njësia e Prokurimit